

E DIELA E KRYQIT

THIRRTORET

Këndohen dhjetë, domethënë shtatë të Tingëllit edhe tri të Triodit më Tingëllin Tërthor I:

PAS KHERIS ASKITIKON

Lum' ti o jetëprurësi Kryq, o i pamundur, flamur i besëmirëve, o portë e Parajsës, që ngazëllon çdo besnik, ti që Kishën tënde, rreth me mur e mpron; prej teje u-batërdis, u-dërmua për gjithënjë, forca e vdekjes, u-përpi edhe krejt u-çduk, dhe u-ngritmë ne, që prej dheut në qiellin. Arm' e pakundrështuarshme, armik i demonëve, lavdi e çdo oshënari, dhe zbukurim i Dëshmorëve; liman i shpëtimit, që i fale tërë botës, mëshirë dhe shpëtim.

Lum' ti o Kryq i Zotit Jesu, që ke larguar, çdo mallkim njerëzor prej nesh, o shenj' e vërtet' e gazit, që po tmerron çdo armik, kur po lartësohesh me nderime sot; o ndihm' e të gjithëve, shigurimi i mbretërve, forc' e priftinjve, bukuri' e të drejtëve, i shënuari, dhe nga tmerr' i shpëtuari; o shkop i gjithë forcave, prej teje po mprohemi, o arm' e paqes për frikën, që adhurohesh prej Engjëjve; lavdia e Krishtit, që i fale tërë botës, mëshirë dhe shpëtim.

Lum' ti që ndrit për çdo verbëri, dhe të sëmuret, i shëron dhe të vdekurit, i ngre që nga varret, që na ke ngritur dhe ne, të rrëzuar poshtë i çëmuar Kryq; prej teje u-çakërdis, forc' e vdekjes dhe lulëzoj; pavdekësia, dhe njeriu u-ngjit në qjell, dhe Satan' i keq, u-dërmua me gjithësej. Sot që po lartësohesh ti, prej gjithë

Peshkopëve, e lartësojmë me besë, të lartësuarin përmi ty, dhe ty t' adhurojmë, që i fale tërë botës, mëshirë dhe shpëtim.

LAVDI, T. III: O Krisht o Perëndia ynë, që dignove kryqësimin vullnetar, për të ngjallur gjindjen njerëzore, kij mëshirë për popullin, që vuan në mëkata dhe rezike, dhe çlirona nga armiqtë si njeridashës.

Tania e Tingëllit, edhe Pasvargjet e Tingëllit.

LAVDI DHE TANI: O Zot që lëftove me Davidin, për të shtypur tiranët, ti përkrah-e popullin tonë, dhe përmbys-i armiqtë, me fuqinë e Kryqit të çëmuar, dhe me nërmjetimet e Nënës sate, dhe dhurona përdëllimin e math.

Përlëshorja e Tingëllit; pastaj:

PERLESHORJA E KRYQIT, T. I. SOSON KIRIE

Ti shpëtoje Zot, edhe ti bekoje popullin, edhe trashëgimin tënt; mundjen edhe triumfin, dhurona kundër barbarëve, edhe ruajna shtetin, me poterën e Kryqit tënt.

Pastaj këndohet Hyjlindësorja e Tingëllit I:

PAS TU LITHU SFRAJISTHENTOS

Kur tha Gabrieli Gëzohu Virgjëreshë, me zërin tok mishërohej, Shpëtimtari dhe Zoti, më ty o ark' e vyer Shën Mari, sikundër tha Profet' i Math David; u-çfaqe më e gjerë se qielli, se mbajte Krijëtarin tënt. Lavdi ati që banoj në gjirin tënt, lavdi ati që lindi prej teje, lavdi ati që na çliroj me lindjen tënde.

SHKURTORJA, T. R.

Nuk e ruan më një shpatë prej flage, derën e Parajsës; se Kryqi e shoj atë zjarr çuditërisht; thumbi i vdekjes, dhe mburrja e Ferrit u-thyen, se Krishti u thirri, të burgosurve në Skëterrë: Hyni përsëri në Parajsë.

SHTEPIA

Pillati nguli tre kryqe në Golgotha, dy për Kusarët edhe një për Krishtin. Kur e pa këtë, Satani u tha të paudhëve: "Shokë, kush ma nguli këtë shpatë në zëmër? Dikush më goditi me një ushtë të drunjtë, dhe ma çori krahërorin; më dhëmbin mushkëritë, u-mbyta në gjak, dhe jam i shtrënguar ta çlironj Adamin me të bijtë; se ky dru i kthen njerëzit përsëri në Parajsë."

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Tretë të Kreshmëve, kremtojmë Adhurimin e Kryqit të çëmuar dhe jetëbërës.

Me fuqinë e tij, o Krisht, o Perëndi, ruajna nga influenza e të paudhit, edhe vlerësona t'i adhurojmë Pasionet e tua dhe Ngjalljen jetëbërëse, pasi t'i kapërcejmë faqebardhë Kreshmët, edhe mëshirona si i mirë dhe njeridashës.

Pastaj Zbritësoret: "Ja gojën e çel tani." Pas Dërgimësoreve Ngjallësore, këndohen:

DERGIMESORET, T. II

PAS TIS MATHITES SINELTHOMEN

Ejani adhurojeni, Kryqin e Shpëtimtarit, që po kremtojmë sot me gas, dhe me mall o besnikë, ejani

përshëndosheni, Zotin që dyke dashur, u-mbërthye për ne mi të, lutjuni që t' arrijmë me ngazëllim, ta kremtojmë Pashkën e lavdëruar, dhe Ngjalljen e triditë, të Jesujt faqebardhë.

O Krijetar i botëve, o Zot i gjithësisë, prej Shën Marisë more trup, dhe njeri pa ndryshuar, për njerëzit na u-bëre, na përsërite shpirtin, të prishur prej mëkatare, ti që linde prej Nënë çuditërisht, pra thërresim besërisht që të gjithë, me lavdërim dhe brohori: Zonj' e jetës gëzohu.

LAVDERIMET

Këndohen pesë të Tingëllit edhe tri të Përshëmbëllta të Triodit më Tingëllin Tëthor IV:

PAS O TU PARADHOKSU THAVMATOS

Ç' është kjo çudi dhe kjo habi! Ja jetëprurësi dru, Kryq' i Shenjtë i Zotit Krisht, po ngrihet me lavdërim, dhe kremtohet me lartësim; e lavdërojnë, anët e botëve, edhe tmerrohet tuf' e demonëve; o ç' farë dhurëti, është kjo për njerëzit me të o Krisht, shpirtet tona i shpëto, o i mëshirëshmë.

Ç' është kjo çudi dhe kjo habi: Si rush të kuq jetëplot, e ka mbajtur të Lartin Zot, me gozhda mi duartë, Kryq' i Shenjtë që ngrihet sot; kështu na hoqi, Zoti në gji të tij, dhe u-dërmua, vdekja me gjithësej; o Kryq i Zotit Krisht, që na shpie në Parajsën lart në qjell, dhe pavdekësi na jep, lavdi më ty o Zot.

Ç' është kjo çudi dhe kjo habi: Kryqi zgjeron edhe zgjat, dhe arrin gjer në qiellin, se me hir të hyjeshmë, tërë botën e shenjtëron, me të dërmohen, kombet e

egëra, me të forcohen, fronet e mbretërve. O shkall' e hyjeshme, me të cilën ngjitemi në qjellin lart, dhe këndojmë besërisht: Lavdi më ty o Krisht.

LAVDI, T. T. IV: Zot i gjithësisë na mësoj, të mos mburremi si Farisianët e paudhë, po të jemi të përunjur si ay vetë, që zbriti gjer në Kryqin dhe në vdekjen. Pra le ta përhirojmë, dhe le t'i themi tok me Publikanin: O Zot që pësove për ne, shpëtoji shpirtet tona.

TANI. E përmibekuar je, o Hyj lindëse Virgjëreshë.

Doksollogji e Madhe. Kur këndohet "Shenjt Perëndi," Prifti e temjanis Kryqin e Çëmuar në alltar, e merr në një dhisk me lule mi krye, del nga dera e veriut, me llambadhe dhe temjanica përpara, vjen në mes të Kishës, ku është një tryezë e stolisur, dhe e rrotullon tri herë, pastaj, dyke shikuar nga lindja, thotë:

PRIFTI: Urtësi, o të drejtë.

Pastaj Prifti e vë Kryqin mi tryezën, dhe e temjanis kryqthi, dyke kënduar Troparin pasonjës një herë:

PERLESHORJA E KRYQIT, T. I. SOSON KIRIE.

Ti shpëtoje Zot, edhe ti bekoje popullin, edhe trashëgimin tënt; mundjen edhe triumfin, dhurona kundër barbarëve, edhe ruajna shtetin, me poterën e Kryqit tënt.

Vallet e përsëritin nga një herë. Pastaj Prifti këndon një herë në Tingëllin II:

TON STAVRON SU PROSKINUMEN

Kryqin tënt e adhurojm' o Kryezot, dhe Ngjalljen tënde të Shenjtë lavdërojmë.

Vallet e përsëritin nga një herë. Pastaj Prifti dhe populli e përshëndoshin Kryqin, dhe Vallet këndojnë këto Tropare në Tingëllin II:

PAS IKOS TU EFRATHA

Kryqi kremtohet sot, si druri jetëprurës, ku Krishti u-mbërthye, dhe nga mallkim' i vjetër, shpëtoj të gjithë njerëzit.

Sot adhurojeni, me mall dhe besë Kryqin, dhe madhështoni Krishtin, që zbriti përmi dhenë, për hirin e besnikëve.

O Kryq i Zotit Krisht, mburonjë dhe përkrahje, fortes' e patronditur, dhe mprojtës i patundur, shpëtim i gjithë njerësve.

LAVDI DHE TANI. Ejani me gëzim, dhe Kryqin e Çëmuar, ku u-mbërthye Krishti, dhe na shpëtoj nga Ferri, me besë përshëndosheni.

Pastaj nis Mesha e Shën Basilit. Në Hyrjen këndohet Përlëshorja e Tingëllit, pastaj:

PERLESHORJA E KRYQIT, T. I.
SOSON KIRIE

Ti shpëtoje Zot, edhe ti bekoje popullin edhe trashëgimin tënt; mundjen edhe triumfin, dhurona kundër barbarëve, edhe ruajna shtetin, me poterën e Kryqit tënt.

Përlëshorja e Shenjtit të Kishës; pastaj:

SHKURTORJA, T.T.IV.
TI IPERMAKHO STRATIGO

Përlufteshës gjenerale këngët mundëse,
Si përhirim që e shpëtove prej tmerreve,
Populli yt po të përshkuan, o Virgjëreshë;
Po sikundër ke fuqi të palëftuarshme,
Prej çfarëdo reziku shpëto-më,
Se po të thërres: Gëzohu, nuse e panusëruar.

Në vëndin e Hymnit Trishenjtor, këndohet:

Kryqin tënt e adhurojm' o Kryezot, dhe Ngjalljen tënde të Shenjtë lavdërojmë. (3 herë)

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

Dhe Ngjalljen tënde të Shenjtë lavdërojmë.

Kryqin tënt e adhurojm' o Kryezot, dhe Ngjalljen tënde të Shenjtë lavdërojmë.

APOSTULLI

Shpëtoje popullin tënt, o Zot, edhe bekoje trashëgimin tënt.

Ty po të thërres, o Zot, o Perëndia im.

Këndimi prej Letrës së Palit për Hebrenjtë.

Vëllezër, le ta ruajmë besën, se kemi një Kryeprift të Math, i cili shkoj në qjell, Jesunë, të Birin e Perëndisë; se nukë kemi një Kryeprift, që nukë dhëmshërohet për dobësitë tona, po të çprovuar më të gjitha, me shëmbëllsinë tonë, pa mëkata. Pra le t'i afrohemi fronit të hirit me kuxim, që ta marrim mëshirën dhe hirin si ndihmës të mirëkohëshme. Se çdo kryeprift, i

cili merret prej njerësve, vëndoset për njerëzit përpara Perëndisë, që të blatonjë dhurata dhe therore për mëkatat, që të jetë zëmërgjerë për të paditurit edhe për të arratisurit, se edhe ay vetë ka dobësira; dhe për këtë arësye detyron të blatonjë dhurata për mëkatat edhe për veten e tij edhe për popullin. Edhe këtë nder nuk e merr njeriu prej vetiu po i thirrur prej Perëndisë si Aaroni. Kështu edhe Krishti nuk u-lavdërua prej vetiu, kur u-bë kryepriфт, po prej ati, që i tha: “Ti je im-Bir, unë sot të kam lindur; ti je priфт për jetë pas urdhërit të Melkishedekut.”

UNGJILLI PAS MARKUT

Zoti tha: Ay, që do të vinjë pas meje, le ta mohonjë veten, dhe le ta ngrerë kryqin e vetë, dhe le të më bjerë pas. Se ay, që do ta shpëtonjë jetën e vetë, do ta humbasë; po ay, që do ta humbasë jetën për mua dhe për Ungjillin, ay do ta shpëtonjë. Se ç’ dobi do të ketë njeriu, në fitoftë botën e tërë dhe në humptë shpirtin e vetë? Se nukë ka asnjë çmim, me të cilin ta blemë shpirtin prapë. Pra, kush të ketë turp për mua dhe për fjalët e mia në këtë brez mëkatar, edhe i Biri i njeriut do të ketë turp për atë, kur të vinjë me lavdinë e Atit i rrethuar prej Engjëjve të shenjtë. Edhe u thoshte: “Me të vërtetë po ju them se disa prej atyre, që ndodhen këtu, nukë do ta ngjërojnë vdekjen, dhe do ta shikojnë të gjallë Mbretërinë e Perëndisë, kur të vinjë me fuqi.”

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Basilit.

KUNGATORE

Drita e fytyrës sate u-shënua përmi ne, o Zot. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të “Pamë Dritën,” këndohet përleshorja e Kryqit.